

## STATUTI

I

### SHOQERISE "VERTUS BLUE COAST" SHPK

#### KREU I DISPOZITA TE PERGJITHESHME

##### Neni 1

Sot me date 06.04.2021, Ortaku I shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "VERTUS BLUE COAST" sh.p.k:

Zj. Nefize Mene, e datelindjes 19.01.1942, lindur ne Permet dhe banuese ne Tirane, madhore dhe me zotesi te plote per te vepruar, mbajttese e leternjoftimit nr. **034289584**, dhe numer personal **E25119036D**;

deklaroje se aktiviteti i metejshem i shoqerise **"VERTUS BLUE COAST" sh.p.k.**, do te rregullohet, organizohet dhe zhvillohet ne perputhje me kerkesat e Ligjit, Nr. 9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

##### Neni 2

Shoqeria **"VERTUS BLUE COAST" sh.p.k.**, është person juridik shqiptar dhe si e tille do te ushtroje aktivitetin e saj tregtar, sipas ketij Statuti dhe Aktit te Themelimit bashkalidhur, dokumente keto te pregatitura konform kerkesave te Ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" dhe legjislacionit shqiptar ne fuqi .

##### Neni 3

Kohëzgjatja e aktivitetit te shoqërisë është fiksuar për një periudhe kohe te pakufizuar.

##### Neni 4

Shoqeria ka si objekt te veprimtarise se saj:

- Dhënie me qira e ambienteve në pronësi të Shoqërisë;
- Ofrimi i shërbimeve në fushën e argëtimit, nëpërmjet koncerteve, diskotekave, pishinave të hapura apo të mbyllura, kënde lojrash për fëmijë, sallave të përgatitjes fizike, aparaturave të teknologjisë së lartë;
- Ofrimi i shërbimeve në fushën e hotelerisë;
- Ofrimi i shërbimeve në fushën e ushqimit nëpërmjet restoranteve, ëmbëltoreve, kafeneve etj.
- Dhënie dhe ofrim shërbimesh, konsulencë dhe asistencë me staf të specializuar për të tretë për këto çështje dhe pa u kufizuar në to, si mbajtje kontabiliteti, drejtim marketingu, konsulencë ligjore, art dizajn etj.;
- Organizimi, promovimi, koordinimi dhe drejtimi i aktiviteteve në fushën e biznesit prodhues shqiptar;



- Kryerja e punimeve në fushën e ndërtimit të objekteve civile, industriale e turistike, prodhimi i materialeve inerte prej guri, rëre, cakulli dhe prodhim qeramike, tulle dhe parafabrikate, prodhim e tregtim të elementeve betonarme, prodhim dhe tregtim të materialeve të imëta, të gatshme dhe gjysëm të gatshme;
- Blerja, shitja dhe administrimi i pasurive të patundshme të cilat janë në interes të Shoqërisë.
- Kryerja e shërbimeve të mirembajtjes etj;

### Neni 5

Selia e shoqërisë është në adresën Autostrada Tirane-Durrës, Km.12, Fshati Gjokaj Tirane, pranë Citypark, me numer pasurie 691/31.

Asambleja dhe drejtimi i shoqërisë, kanë kompetencën të hapin filiale e agjensi të tjera dhe t'i mbylle nëse e cmon të nevojshme.

## KREU II KAPITALI THEMELTAR DHE KUOTA

### Neni 6

Kapitali themeltar i shoqërisë përbehet vetëm nga kontribute në para dhe është 100.000 leke. Ky kapital është i ndarë në 1 kuotë (një) kuotë me vlerë nominative 100.000 leke.

Kuotat në përqindje të kapitalit themeltar të shoqërisë janë:

- në pronësi të Ortakut të vetëm **Zj.Nefize Mene**, e cili zotëron 100 % (njëqind përqind) të kuotave e barabartë me shumën 100 000 leke.

Për vërtetimin e pronësisë mbi kuotat e mësipërme shoqëria tregtare mund të lëshojë në emër të personit apo të personave, që zotërojnë kuotën, një certifikatë për të vërtetuar zotërimin e kuotës së kapitalit.

## KREU III TRANSFERIMI I PJESEVE NOMINATIVE TË KAPITALIT THEMELTAR

### Neni 7

Kuotat e kapitalit janë lirisht të transferueshme, midis ortakëve, bashkëshortëve të tyre në rastin e ndarjes së pasurisë në bashkëpronësi familjare dhe trashëgimtareve në rast vdekje.

Transferimi i pjesëve nominative të kapitalit themeltar tek të tretet bëhet me miratimin e shumicës së ortakëve që përfaqësojnë të paktën  $\frac{3}{4}$  e kapitalit themeltar, në përputhje me procedurën që vijon:

Ortaku që kërkon të transferojë kuotën e tij, tek të tretet, tërësisht apo pjesërisht, është i detyruar që fillimisht t'i rezervojë ortakëve të tjerë të drejtën e parblerjes. Për të lejuar ushtrimin e kësaj të drejte, ortaku që dëshiron të transferojë kuotën e tij duhet të lajmërojë me shkrim (me letër-rekomandë) gjithë ortakët që figurojnë në Statut (në shtëpinë e secilit, me adresat që rezultojnë në këtë statut), duke e specifikuar çmimin e shitjes, mënyrën e pagesës dhe emrat e blerësve të mundshëm.

Nëse njoftimi nuk i arrin marrësit, ajo do të konsiderohet e mbërritur nga të dy palët në datën kur postieri konfirmon datën e dorëzimit në adresën e përcaktuar në këtë Statut.

Përgjigja e ofertës për te ushtruar te drejtën e parablerjes duhet t'i kthehet ortakut ofertues, me shkrim (me letër-rekomandë), brenda 30 ditëve, nga data që ortaku (ose ortakët) e interesuar kanë marrë njoftimin për ofertën e shitjes.

Ne rast se asambleja refuzon (me shkrim) dhënien e miratimit, ortakët brenda tre muajve nga data e refuzimit, janë të detyruar të blejnë apo të lejojnë blerjen e kuotës në favor të blerësit të caktuar nga ortaku ofertues, me të njëjtin çmim dhe me të njëjtën mënyrë likuidimi që ortaku ofertues ka vendosur në njoftim.

Ne rast se asnjëri nga ortakët në veçanti apo asambleja në përgjithësi nuk përgjigjen brenda 3 (tre) muajve, (nga data e njoftimit të ofertës), miratimi i transferimit konsiderohet i dhënë dhe ortaku ofertues, është i lire ta transferojë kuotën tek te tretet.

## KREU IV ASAMBLEJA

### Neni 8

Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimor i shoqërisë, që përfaqëson tërësinë e ortakeve.

Vendimet e saj merren në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe këtij Statuti dhe janë të detyrueshme për të gjithë ortakët. Ato protokollohen në regjistër të veçante në përputhje me ligjin.

Asambleja ka të drejtë të ushtronte në çdo moment verifikime mbi administrimin dhe të kontrollojë çdo dokument të shoqërisë. Ajo mund të urdhërojë apo të udhëzojë administratorin në kryerjen e detyrës së tij.

Asambleja vendos për përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë; ndryshimet e statutit; emërimin e shkarkimin e administratorëve, e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar sic edhe përcaktimin e shpërblimeve për to; mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen dhe miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë; zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit; pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre; përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve; riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë; miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë; çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti;

## Menyra e Thirrjes së Asamblesë

### Neni 9

Asambleja thirret nga Administratori ose nga çdo ortak që përfaqëson të paktën 5% të kapitalit, nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, me njoftim nëpërmjet postës elektronike.

Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Megjithatë janë të vlefshme edhe mbledhjet e asamblesë që nuk janë thirrur si më sipër, nëse është i përfaqësuar i gjithë kapitali dhe asiston administratori dhe eksperti kontabël i miratuar (nëse ekziston).

Në asamble mund të marrin pjesë të gjithë ata që figurojnë të regjistruar në librin e ortakeve.

Ortakët mund të përfaqësohen vete, ose nëpërmjet një personi të pajisur me prokurë, jo administrator, jo ekspert kontabël i autorizuar ose vartës i vete shoqërisë apo ndonjë shoqërie tjetër të kontrolluar prej saj. I takon administratorit të verifikojë të drejtën e pjesëmarrjes për secilin ortak.



Çdo ortak ka te drejtën e votës ne asamble ne proporcion me kuotën qe zotëron ne kapitalin e shoqërisë.

Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për vlerësimin e veprimtarisë së tij, shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij, ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria, dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

#### Neni 10

Asambleja drejtohet nga administratori dhe ne mungese te tij pjesëmarrësit me shumice absolute te kapitalit prezent ne salle, zgjedhin një drejtues.

Asambleja emëron një sekretar edhe jo ortak. Vendimet e asamblesë duhet te nënshkruhen nga te gjithë ortakët prezent ne mbledhje si dhe nga sekretari.

#### Neni 11

Kur ne Ligj apo ne Statut nuk parashikohet ndryshe, vendimet e asamblesë merren nga një ose disa ortakë qe përfaqësojnë me shume se 30 për qind të kuotave. Ne rast se nuk arrihet kjo, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë, vendosen nga ortakët qe përfaqësojnë te paktën  $\frac{3}{4}$  e pjesëve te kapitalit themeltar.

Asambleja e Përgjithshme me nismën e saj ose me kërkesën e ortakëve qe përfaqësojnë te paktën 5% te kapitalit themeltar, mund të vendosë nisjen e një hetimi të posaçëm për parregullsitë përgjatë veprimeve të themelimit të shoqërisë apo të ushtrimit të veprimtarisë tregtare. Hetimi kryhet nga një ekspert i pavarur i fushës.

Nëse Asambleja e Përgjithshme, kërkesën e ortakëve qe përfaqësojnë te paktën 5%, për nisjen e një hetimi te posaçëm e refuzon ose nuk jep përgjigje brenda 60 ditëve atëherë, kërkuësit kane te drejte ti drejtohen gjykatës.

#### Neni 12

**Zmadhimi i kapitalit themeltar** vendoset nga asambleja e ortakëve. Pas vendimit te asamblesë për zmadhimin e kapitalit, ortakët brenda 30 ditëve duhet te bëjnë derdhjet respektive, ne proporcion me kuotën e kapitalit qe zotëron secili.

Ortakët qe kane votuar kundra zmadhimit te kapitalit nuk janë te detyruar te kontribuojnë.

Depozitimi i kapitalit te zmadhuar, behet vetëm nga ortakët qe kane votuar pro rritjes se kapitalit, secili sipas kuotës qe është vendosur ne asamble. Ne mungese marrëveshje për rindarjen e kuotave, barazohet me 100 (njëqind) shuma e kapitalit pas zmadhimit. Pas derdhjes se kontributeve te sipërpërmendura, administratori duhet te regjistroje ne librin e ortakëve zmadhimin e kapitalit, duke marre nënshkrimin e atyre qe kane pranuar; si dhe te vazhdoje me një përshkrim te ndarjes se kapitalit midis ortakëve.

Administratori me ligj dhe pa autorizim paraprak te asamblesë, mund t'u kërkoje llogari ortakëve qe kane nënshkruar zmadhimin e kapitalit, për derdhjen e kontributeve brenda afatit te sipërpërmendur.

**Zvogëlimi i kapitalit** vendoset nga ortakët qe përfaqësojnë te paktën  $\frac{3}{4}$  e pjesëve te kapitalit themeltar.

Kur vendimi i zvogëlimit te kapitalit nuk motivohet nga humbjet ne aktive, kreditorët e shoqërisë duhen njoftuar menjëherë; ata mund te kundërshtojnë vendimin pranë organeve gjyqësore.

**Transformimi i shoqërisë** ne shoqëri anonime, behet mbas hartimit te raportit përkatës nga Administratori dhe miratimit nga Asambleja e Përgjithshme me një shumicë prej tre të

katërtave, ne përputhje me nenet 228 dhe 229 te Ligjit "Për Tregtarin dhe Shoqëritë Tregtare". Është i pavlefshëm çdo transformim i shoqërisë ne kundërshtim me këtë dispozite.

## ADMINISTRIMI

### Neni 13

Administrimi dhe përfaqësimi i shoqërisë i besohet një Administratori te vetëm, qe mund edhe te mos jete ortak. Administratori i vetëm do te emërohet për një periudhe 1-vjeçare, me te drejte ripërtëritjeje, me përjashtim dorëheqje apo shkarkimi nga ana e Asamblesë.

Ne detyren e Administratorit te shoqërisë, e emeruar per nje periudhe kohe 1 vjecar, me te drejte riemerimi eshte **Nefize Mene**, e datelindjes 19.01.1942, lindur ne Permet dhe banuese ne Tirane, person madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, mbajtese e leternjoftimit nr. **034289584**, dhe numer personal **E25119036D**, e cila ka te drejtën e firmës dhe te përfaqësimit te shoqërisë.

Administratori gëzon kompetenca te pakufizuara për realizimin e objektit te veprimtarisë se shoqërisë, me përjashtim te atyre kompetencave qe Statuti ia njej Asamblesë se Pergjithshme.

Ne përmbushje te detyrës se tij, ai ka te drejte dhe detyrim te kryej të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme; te përfaqësoj shoqërinë tregtare; te kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë; te përgatis dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, të paraqesë këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim; te krijoj një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë; te kryejë regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit; te raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare,

Administratori kryen edhe detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut si edhe mund te vere ne lëvizje instanca juridike dhe administrative, duke emëruar avokate e duke lëshuar prokura ne raste gjyqesh, duke kryer operatione bankare, këtu përfshire edhe hapjen e llogarive rrjedhëse, nënshkrimin dhe xhirimin e çeqeve, realizimin e tërheqjeve dhe derdhjeve me leke ne dore apo urdhër xhirimi, tituj krediti, paradhënie krediti.

Viti ekonomik fillon me 01 Janar deri me 31 Dhjetor çdo viti.

### Neni 14

Administratori mund te emëroje përfaqësues, te cilëve, individualisht apo kolektivisht, mund t'u japë te drejtën e firmës, si dhe ato kompetenca, shpërblime e garanci qe do te vlerësoje te arsyeshme. Ajo mundet gjithashtu te emëroje drejtues ose përfaqësues për akte apo kategori aktesh te caktuar.

## Përgjegjësitë e Administratorit

### Neni 15



Administratori (apo administratoret nëse do te emërohen te tille) janë përgjegjëse individualisht ose solidarisht, sipas rastit, ndaj shoqërisë ose te tretëve, për shkeljet ligjore te Statutit apo faje te kryera gjate administrimit te shoqërisë.

Shoqëria nuk është përgjegjëse ndaj te tretëve, për aktivitete te kryera nga administratori ne kundërshtim me kompetencat e tij, kur vërtetohet se ata ishin ne dijeni te kësaj rrethane.

Administratori përgjigjet personalisht para shoqërisë dhe/ose te tretëve qe kane pësuar dëme nga ndonjë veprim i tij i paligjshëm.

#### Neni 16

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi

### PERFAQESIMI I PUNEMARRRESVE

#### Neni 17

Nëse shoqëria ka me shume se 50 punonjës atëherë ata kane te drejtën te organizojnë një Këshill te punëmarrësve me një mandat 5-vjeçar me te drejte ripërtëritje ose kur shoqëria ka te punësuar me shume se 20 punëmarrës po me pak se 50 atëherë për çdo 10 punëmarrës zgjidhet një përfaqësues. Këshilli i Punëmarrësve apo përfaqësuesit e tyre gëzojnë te gjitha te drejtat dhe detyrimet e parashikuara nga neni 20 i Ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

### EKSPERTI KONTABEL I REGJISTRUAR

#### Neni 18

Emërimi i ekspertit kontabël te regjistruar behet me vendim te asamblesë se përgjithshme e cila përcakton mandatin dhe shpërblimin.

Kur ligji e parashikon shprehimisht prezencën e ekspertit kontabël te regjistruar, janë te pavlefshme operacionet e kryera pa prezencën e tij.

#### Neni 19

Eksperti Kontabël i regjistruar pasi ka verifikuar librat kontabël, arkën dhe depozitat bankare, garanton qe kontabiliteti vjetor është mbajtur ne rregull, i korrespondon te vërtetës dhe është ne përputhje me legjislacionit ne fuqi.

Mund te shkarkohet nga funksionet e tij me vendim te asamblesë se përgjithshme si dhe me vendim gjykate.

Eksperti Kontabël i regjistruar përpilon dhe i paraqet Asamblesë një raport financiar mbi ushtrimin vjetor qe pasqyron situatën financiare ne nisje dhe atë ne mbyllje.

Kontrollon qe bilanci përfundimtar dhe Raporti i përpiluar nga Administratori për Asamblenë, t'i korrespondoje realitetit.

Është i detyruar ti paraqesë Administratorit dhe asamblesë se ortakeve:

a) Kontrolltet, verifikimet dhe sondazhet e bëra ;

b) Zërat e bilancit dhe dokumentacionin kontabël që duhet korrigjuar duke sygjeruar edhe zgjidhjet;

c) Gabimet dhe pasaktësitë e konstatuara ;

d) Rezultatin financiar pas korrigjimeve të bëra;

Ai duhet të thirret në të gjitha mbledhjet e asamblesë së ortakëve ku aprovohet bilanci i aktivitetit gjithë vjetor, por mund të thirret në të gjitha rastet kur konsiderohet e nevojshme.

#### Neni 20

Eksperti kontabël i regjistruar përgjigjet ndaj shoqërisë dhe ndaj të tretëve për pasojat e negative që rrjedhin nga gabime e neglizhime në kryerjen e funksionit të tij.

Nuk mban përgjegjësi për shkeljet ligjore të kryera nga administratori, me përjashtim të rasteve kur ka pasur dijeni për to, por nuk ia ka paraqitur dhe raportuar asamblesë.

### KREU IV

#### FITIMIT DHE FONDET

##### Neni 21

Fitimi që do të shpërndahet përbehet nga fitimet e realizuar gjatë vitit financiar të sapa mbyllur. Asambleja mund të vendosë për formimin dhe shpërndarjen e fondeve të ndryshme.

##### Neni 22

Asambleja pasi ka miratuar bilancin përfundimtar dhe ka vendosur shumën që do të shpërndahet, përcakton pjesën e fitimit për secilin ortak në raport me kuotën që zotëron secili.

Shoqëria mund t'u shpërndajë fitime ortakëve, vetëm nëse administratoret, nën përgjegjësinë të tyre personale, lëshojnë një certifikatë të aftësisë pagese, e cila konfirmon shprehimisht se shpërndarja e propozuar e dividendëve përmbush kërkesat nën 77 të Ligjit "Për Tregtarin dhe Shoqëritë Tregtare"

Gjatë vitit, shoqëria ka të drejtë t'i japë ortakëve paradhënie mbi dividendët në vlera jo më të mëdha se dividendi i shpërndarë një vit më parë, me kusht që:

a) Të mbetet e depozituar një rezerve, e barabartë me paradhëniet që do të shpërndahen;

b) Një Ekspert kontabël i regjistruar të vërtetojë në një relacion me shkrim që fitimet neto të realizuara deri në atë moment janë më të mëdha se paradhëniet që parashikohen për të shpërndarë ortakëve.

Shpërndarja e paradhënieve vendoset nga asambleja ose administratori. Në vendimin përkatës duhet të specifikohen shumat dhe datat e kthimit.

Dividendët që nuk korrespondojnë me fitimet e realizuara realisht, mund t'u reklamohen ortakëve që i kanë marrë ato.

### KREU V

#### PAVLEFSHMERIA, PRISHJA DHE LIKUJDIMI DHE LARGIMI I ORTAKEVE

##### Neni 23

Statuti si dhe aktet e tjera te shoqërisë mund te konsiderohen te pavlefshëm, vetëm ne rast se shkelen dispozitat e parashikuara nga Ligjin Nr.9901, date 14.04.2008 "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare" ose nga Kodi Civil.

#### Neni 24

Shoqëria mund te priset vetem ne keto raste:

- me vendim unanim të asamblesë së përgjithshme;
- me hapjen e procedurave të falimentimit;
- nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- me vendim të gjykatës;

### LARGIMI DHE PERJASHTIMI I ORTAKEVE

#### Neni 25

Ortaku mund të largohet nga shoqëria nëse ortakët e tjerë ose shoqëria kanë kryer veprime në dëm të tij, nëse është penguar të ushtrojë të drejtat e tij, nëse shoqëria i ka ngarkuar detyrime të paarsyeshme apo për shkaqe të tjera, që e bëjnë të pamundur vazhdimin e ortakërisë pasi te njoftoje me shkrim për arsyet e largimit shoqërinë.

Në bazë të një vendimi të zakonshëm, asambleja e përgjithshme mund t'i kërkojë gjykatës përjashtimin e ortakut, nëse ai nuk ka shlyer kontributin e tij, sipas parashikimeve të statutit ose nëse ekzistojnë shkaqe të tjera të arsyeshme për këtë përjashtim.

Ne këto raste zbatohen parashikimet e neneve 102, 103 dhe 104 te Ligjit "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare".

### LIKUIDIMI

#### Neni 26

Kur me vendim gjykate shpallet pavlefshmëria absolute apo relative e shoqërisë si dhe ne rastet e parashikuara ne statut, asambleja e përgjithshme vendos prishjen e parakohshme te shoqërisë dhe fillojnë procedurat e likuidimit qe do te kryhen sipas kërkesave te parashikuara ne Ligjin "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare" dhe ne përgjithësi nga legjislacioni shqiptar ne fuqi.

### ORTAKU I VETEM I SHOQERISE

#### NEFIZE MENE

*Nefize Mene*  
